



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 114 Prot

Tiranë, më 12.07, 2012

**VENDIM Nr. 207, dt. 12.07.2012**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.07.2012 pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i **HEC Stavec (Martanesh)** mbi bazën e kërkesës së **Subjektit "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k., Dibër/Burrel,**

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve **HEC Stavec (Martanesh)**, paraqitur nga Subjekti **"Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k., Dibër/Burrel.**
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Dibër bazuar në kontratën dypalëshe midis **"Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k.** dhe **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.**
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori (**"Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k.**) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**

*Bumçi*

**SEKRETAR I KKA**  
**ROLAND OLLI**

*R. Olli*



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al